



Pranimi / Dostava Priloge / Priloge Received / Delivery		10.02.2022		2	viti god year
Organ / Organizacija Organ / Ujednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPMSHCK	663/2022		1/4		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.21/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1360/20 të datës 28.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.170/2020 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga ankuesi ne adresë banim kundër vendimit me numër protokolli 3392 të datës 17.04.2020 të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.170/2020 e datës 22.06.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET** vendimi me numër protokolli 3392 të datës 17.04.2020 të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve.
- III. OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15)ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi nga dita e pranimin të tij, duke anuluar vendimin me numër protokolli 3392 të datës 17.04.2020 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Teknike, Pronave, Sigurisë Rrugore dhe Peshoreve në Departamentin e Menaxhimit të Rrugëve”, me datë 24.04.2020 ka parashtruar kërkesë tek Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për shfuqizimin e vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve.

Ankuesi pasi që nuk mori asnjë përgjigje nga Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.05.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3764 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Pasi që nuk mori përgjigje nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 22.06.2020 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1208/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Infrastrukturës. Më datë 08.07.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokollit 1329 /2020 nga Ministria e Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me njoftimin e datës 07.08.2020 me numër të protokollit 1488/2020 e ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e tij të datës 22.06.2020 dhe se e ka udhëzuar ankuesin që ti ndjek më tutje procedurat ligjore. Ankuesi ka parashtruar padi me datë 21.08.2020 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 28.12.2021 merr Aktgjykimin me numër A.nr.1380/20 me të cilin aktgjykimin aprovohet kërkesëpadija e paditësi anullohet akti administrativ (njoftimi) i datës 07.08.2020 dhe e detyron Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të marrë vendim të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 22.06.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.06.2020 me numër protokollit 1208/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Opinioni ligjor i datës 05.11.2019 me numër protokollit 3316 i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesë e datës 24.04.2020 e parashtruar tek Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimi i datës 17.04.2020 me numër protokollit 3392 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Akt emërimi i datës 01.12.2011; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të emërimit i datës 13.04.2018 për Ankesë e datës 14.05.2020 me numër protokollit 3704 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Infrastrukturës; Njoftimi i datës 07.08.2020 me numër protokollit 1488/2020; Aktgjykimi A.nr.1380/20

i datës 28.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 08.07.2020 me numër protokollit 1329/2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/13.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve, ka vepruar në kundërshtim dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se **“4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj”**, në vendim nuk përcaktohet fare kohëzgjatja sa do të qëndrojë ushtrues detyre. Sipas informatave që kam marrë me telefon nga Menaxherja e Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kemi konstatuar se i njëjti është ende në pozitën e ushtruesit të detyrës prej datës 17.04.2020.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 83 paragrafi 10 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se **“10. Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës.”**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe provave të lëndës ka konstatuar se vendimi për ushtrues detyre i datës 17.04.2020 është nxjerrë në kundërshtim Dispozitat e nenit 4, 6 dhe 10 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 19 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ku përcaktohet se **“4. Drejtori i departamentit, në rast të mungesës, zëvendësohet nga udhëheqësi i divizionit, i caktuar me shkrim nga vetë drejtori apo, në rast pamundësie shëndetësore, caktohet me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm”** ndërsa kandidati ka pas pozitën Inspektor i Infrastrukturës Rrugore me koeficient 7 dhe është caktuar në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara në pozitën e Ushtruesit të detyrës.

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar sepse Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës vendimin me numër protokollit 3392 të datës 17.04.2020 për emërimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve e ka nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil në fuqi dhe si i tillë i njëjti vendim duhet të shfuqizohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.21/2022,datë 09.02.2022

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Gjyqtari
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

